



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 409/5 prot.

Tiranë, më 30.10.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 789, datë 25.7.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Palaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dëjani:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 16.10.2024, është njoftuar vendimi nr. 789, datë 25.7.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj, aktualisht me detyrë ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 789, datë 25.7.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Palaj, aktualisht ushtron detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe, në zbatim të pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Palaj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezultoi se:

2.1 *ILDKPKI*, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Albana Palaj*”<sup>2</sup> ka referuar se:

- i Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për pasuritë dhe për të ardhurat;*
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 *AKSIK*, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2017, i *AKSIK*, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2023, të KDZH-së, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana \*\*\* Palaj (\*\*\*)*”.

2.3 *KLJGJ*, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin<sup>3</sup> për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** [...] *Trupi gjykues çmoi se, pas përfshirjes në analizë të të ardhurave të fituara në emigracion nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, sipas vërtetimeve të përcjella me prapësimet, të cilat janë trajtuar gjerësisht më lart në këtë vendim, analiza financiare para marrjes së detyrës rezultoi me vlerë negative -15,444,142 lekë, ndërsa nuk ndryshon për periudhën në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Në përfundim, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk rezultuan problematika, të cilat kanë të bëjnë me deklaram të pamjaftueshëm apo mungesë burimesh të ligjshme të krijimit të tyre, të cilat të jenë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Rezultoi e provuar se pasuritë janë krijuar kohë përpara se subjekti të ushtronte detyrën e ndihmëses ligjore dhe me të ardhurat e bashkëshortit të saj. Subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit [...].*

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.4.2018.

<sup>3</sup> Raport i KLGJ-së nr. \*\*\*/\* prot., datë \*\*.6.2023.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** [...] Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, Deklaratën për kontrollin e figurës, Raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose që të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës [...].

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] Në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të nenit 59, pika 1, shkronja “c”, trupi gjykues e konsideron subjektin e rivlerësimit të aftë në kryerjen e funksionit të ndihmësës ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër [...].

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, ka vendosur:

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj, aktualisht ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**5.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**6.** Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**7.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**8.** Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 789, datë 25.7.2024, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**9.** Për sa më sipër, në konsideratë të faktit se Kolegji ka juridiksionin e posaçëm dhe të vetëm për të përcaktuar kualifikimet ligjore për çështjet që i përkasin procesit të rivlerësimit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2,

nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 789/2024 të Komisionit.

### III. Analiza e shkaqeve të ankimit

**10.** Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

**11.** Nga shqyrtimi i Deklaratës “Vetting”, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, në datën 28.1.2017, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi janë:

#### **12. Pasuria e paluajtshme “Godinë e kombinuar 3 kate dhe tokë me sip. 1,412 m<sup>2</sup>”**

12.1 Në D-Vetting, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: (i) Tokë 1.412 m<sup>2</sup>, e blerë me kontratë shitblerje me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.5.2002, certifikuar nga ZVRPP Shkodër, datë lëshimi \*\*.5.2002. Vlera 100.000 lekë, pjesa takuese 100%. (ii) Tek pasuria 1.412 m<sup>2</sup> ndërtuar godinë e kombinuar në tri kate për banim dhe aktivitet (380 m<sup>2</sup> banim dhe 223.2 m<sup>2</sup> për aktivitet), e legalizuar dhe certifikuar, realizuar me punonjës të palicencuar (jo firmë ndërtimi, prandaj dhe shpenzimet deklarohen pak a shumë në saje të shënimeve individuale). Vlera 15.000.000 lekë, pjesa takuese 100%.

12.2 Referuar akteve të përcjella nga ASHK-ja, me shkresën nr.\*\*\*/\* prot., datë \*\*.4.2024, dhe të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur D-Vetting, rezulton:

12.2.1 Në emër të bashkëshortit të subjektit është regjistruar pasuria Arë + Truall, me sip. 1,412 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\*/\*\*, në \*\*\* \*\*\*, Shkodër. Kjo pasuri është blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.5.2002, kundrejt vlerës 100,000 lekë.

12.2.2 Sipas formularit “Për legalizimin e ndërtimit pa leje”, nr.\*\*\* prot., datë \*\*.7.2013, rezulton se \*\*\* \*\*\*, Shkodër, me sipërfaqe të përgjithshme të ndërtimit 726 m<sup>2</sup>, sipërfaqe baze 223 m<sup>2</sup>, 3 kate e kombinuar për banim + repart pune. Sipërfaqe e truallit të ndërtimit pa leje 2,000 m<sup>2</sup>.

12.2.3 Referuar fotografive të objektit bashkëlidhur përgjigjes së ASHK-së Shkodër konstatohet se, deri në datën e aplikimit për legalizim, datë \*\*.7.2013, objekti është ende i papërfunduar (ngritur karabinaja dhe muraturë).

12.2.4 Sipas procesverbal - konstatimi i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Qarku Shkodër, datë \*\*.9.2013, për objektin e kombinuar të deklaruar nga \*\*\* \*\*\*, rezulton se sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 600 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e bazës 223.2 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit 603.2 m<sup>2</sup> dhe numri i kateve mbi tokë 3. Objekti i deklaruar shfrytëzohet sipërfaqe 380 m<sup>2</sup> për banim dhe sipërfaqe 223.2 m<sup>2</sup> për aktivitet social ekonomik.

12.2.5 Sipas lejes së legalizimit nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2014, për objektin “*Godinë e kombinuar tri kate*”, që i jepet z. \*\*\* \*\*\*, me adresë \*\*\* \*\*\*, Komuna \*\*\*, rezulton sipërfaqe totale ndërtimit: (i) për banim 330 m<sup>2</sup> dhe (ii) për aktivitet 223.2 m<sup>2</sup>. Numri i kateve mbi tokë 3.

12.3 Komisioni, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, ka konstatuar se pasuria është krijuar përpara se subjekti i rivlerësimit të merrte detyrën dhe është krijuar/regjistruar në emër të bashkëshortit të saj.

12.4 Lidhur me koston e ndërtimit të objektit të legalizuar, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në D-Vett., ka deklaruar se objekti është realizuar me punonjës të palicencuar dhe shpenzimet deklarohen pak a shumë në saje të shënimeve individuale në vlerën 15,000,000 lekë.

12.5 Komisioni, në analizën financiare për burimin e krijimit të këtyre pasurive, ka marrë në konsideratë se ndërtimi i banesës ka filluar pas kthimit në Shqipëri të subjektit të rivlerësimit (deklaruar fundviti 2004, pra nga fillimi i vitit 2005), duke qenë në pamundësi të përcaktimit të saktë të kohës së kryerjes të punimeve dhe ka shpërndarë koston e investimit në mënyrë të njëtrajtshme gjatë periudhës 2005-2014.

12.6 Komisioni, lidhur me koston e ndërtimit, ka përfshirë në analizë financiare vlerën e deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti në D-Vetting, si kosto investimi prej 15,000,000 lekësh, pasi: (i) nga hetimi nuk u arrit të përcaktohej saktësisht koha e punimeve dhe se sa ndërtim është kryer në secilin vit, për të kryer llogaritje të sakta me referencat e EKB-së në çdo vit. (ii) Bashkëshorti deklaroi se punimet në objekt janë kryer nga punonjës të palicencuar, të cilët kanë kryer punë informale. Sipas metodologjisë së Komisionit, në rastet e ngjashme është aplikuar zbritja e vlerës së TVSH-së, fitimit të parashikuar etj. Duke përdorur këtë mënyrë llogaritje, rezultoi se vlera e ndërtimit të objektit është rreth vlerës së deklaruar nga bashkëshorti në D-Vetting. (iii) Duke iu referuar koston të ndërtimit nga EKB-ja rezultoi se të dhënat i referohen qytetit të Shkodrës dhe jo zonave rreth saj, kosto e të cilave mund të jetë e ndryshme nga vlera e qytetit të Shkodrës.

12.7 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar: *(i) Duket se kjo pasuri është krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit. (ii) Duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi të krijojnë pasurinë me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar me pamundësi financiare në vlerën 8,238,964 lekë (100,000 lekë blerja e truallit + 8,138,964 lekë ndërtimi i objektit).*

12.8 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet përfundimtare, ndër të tjera, lidhur me pamundësinë financiare për ndërtimin e këtij objekti, ka deklaruar: *[...] për sa i përket mundësisë financiare për ndërtimin e këtij objekti, unë jam në pamundësi objektive për të provuar ligjërisht një fakt të tillë, por Komisioni, po të marrë në konsideratë të ardhurat “de facto”, të realizuara nga ana ime dhe bashkëshorti im në emigracion (e ndërtuar me të ardhurat e realizuara me mundin dhe sakrificën mbi 20-vjeçare në emigracion), kjo pasuri është më se e justifikuar [...].*

12.9 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se: *[...] pasuritë si më lart janë krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe se, për shkak të kohës së gjatë të krijimit të pasurisë, periudhës së gjatë të krijimit të të ardhurave të përdorura për investimin në pasuri, faktit të njohur të impaktit të remitancave nga emigrantët në ekonominë e vendit dhe të të ardhurave informale të përfituara prej tyre gjatë kësaj periudhe, çmon se pamundësia*

*financiare e rezultuar nuk duhet të vlerësohet penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së saj. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit [...]<sup>4</sup>.*

12.10 Në vlerësim tërësor për kriterin e pasurisë, Komisioni, ndër të tjera, ka vlerësuar se: [...] *Trupi gjykues çmoi se, pas përfshirjes në analizë të të ardhurave të fituara në emigracion nga subjekti dhe bashkëshorti i saj sipas vërtetimeve të përcjella me prapësimet, të cilat janë trajtuar gjerësisht më lart në këtë vendim, analiza financiare para marrjes së detyrës rezulton me vlerë negative -15,444,142 lekë, ndërsa nuk ndryshon për periudhën në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Në përfundim, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se, nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk rezultuan problematika, të cilat kanë të bëjnë me deklaram të pamjaftueshëm apo mungesë burimesh të ligjshme të krijimit të tyre, të cilat të jenë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Rezultoi e provuar se pasuritë janë krijuar kohë përpara se subjekti të ushtronte detyrën e ndihmës ligjore dhe me të ardhurat e bashkëshortit të saj. Subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit [...]<sup>5</sup>.*

12.11 Komisioneri Publik konstaton se, bazuar në parashikimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

12.12 Bazuar në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

12.13 Lidhur me pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit para fillimit të detyrës, Komisioneri Publik çmon të sjellë në vëmendje se Kolegji i Posaçëm i Apelit, në drejtim të interpretimit të dispozitave ligjore të paketës së reformës në drejtësi, lidhur me momentin e krijimit të këtyre pasurive, ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar, e cila ka konfirmuar qëndrimin, sipas së cilit, për vlerësimin e pasurisë, ligji nuk kufizon as kohën dhe as cilësinë që subjektet e rivlerësimit kanë pasur në momentin e krijimit të tyre.

12.14 Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në përfundim të hetimit administrativ, nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për mbulimin me burime të ligjshme të pasurive “*Godinë e kombinuar 3 kate dhe tokë me sip. 1,412 m<sup>2</sup>*”, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

### **13. Likuiditete cash në banesë, në shumën 1.000.000 lekë**

13.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Gjendje CASH në banesë, të tërhequr pranë \*\*\* Bank, nga llogaria \*\*\* (të ardhura nga paga). Vlera 1,000,000 lekë. Pjesa takuese 100%*”.

<sup>4</sup> Referohuni arsytimit të Komisionit, f. 13 e vendimit.

<sup>5</sup> Referohuni arsytimit të Komisionit, f. 20 e vendimit.



14.3 Tokë me sipërfaqe 600 m<sup>2</sup>, e blerë me kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.5.2002, certifikuar nga ZVRPP Shkodër, datë lëshimi \*\*.3.2003. Vlera: 300,000 lekë. Pjesë takuese: 100%

14.3.1 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK-ja<sup>7</sup> rezulton se pasuria Arë, me sipërfaqe 600 m,<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\*/\*\*, në \*\*\* \*\*\*, Shkodër, figuron e regjistruar në emër të \*\*\* \*\*\*. Nga aktet e depozituara nga subjekti, bashkëlidhur D-Vetting, rezulton se kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti i subjektit me kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\* kol., datë \*\*.3.2003, kundrejt vlerës 300,000 lekë, nga shtetasit \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*.

14.4 Automjet furgon (9+1), tip "Ford", me targë CL\*\*\*XH, blerë cash në Itali, për përdorim vetjak (disponoj dokumentacionin e pronësisë, por jo një kontratë shitblerjeje). Vlera: 8,000 euro. Pjesa takuese: 100%.

14.4.1 Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur D-Vetting, ka depozituar certifikatën e pronësisë së mjetit, me targë CL\*\*\*XH, lëshuar në datën \*\*.4.2009 nga institucionet italiane. DPSHTRR-ja nuk e konfirmon këtë automjet në emër të bashkëshortit të subjektit, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit informon se shtetasi \*\*\* \*\*\* ka në pronësi mjetin me targa të huaja italiane, CL\*\*\*XH dhe, sipas sistemit TIMS, rezulton se ky automjet është përdorur brenda territorit të Shqipërisë, nga bashkëshorti i subjektit, prej datës \*\*.4.2009.

14.5 Komisioni, në përfundim të hetimit administrative, ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të pasurive dhe të shpenzimeve të kryera nga subjekti dhe personat e lidhur, para dhe pas fillimit të detyrës, përfshirë edhe pasuritë e cituara më sipër në këtë ankim. Nga analiza financiare e kryer për periudhën nga marrja e detyrës, qershor 2015-2016, subjekti ka rezultuar me vlerë negative prej -546,547 lekë. Ndërsa për periudhën përpara marrjes së detyrës, 1997-maj 2015, rezulton me vlerë negative prej – 17,443,455 lekë (kjo vlerë përfshin dhe pamjaftueshmërinë e trajtuar më sipër në këtë ankim lidhur me pasuritë *godinë e kombinuar 3 kate dhe tokë me sip. 1,412 m<sup>2</sup>*). Në vijim, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

14.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Më datë \*\*.7.2024, me kërkesë të bashkëshortit tim, \*\*\* \*\*\* (me email) është siguruar (estratto conto) pasqyra e llogarisë së sigurimeve shoqërore, e përditësuar në emër të tij (ku figurojnë të ardhura edhe për vitin 2002 dhe 2003, në vlerën 11.652.00 euro), si dhe (estratto conto) pasqyra e llogarisë së sigurimeve shoqërore në emrin tim, Albana Palaj. Në këtë tabelë kontributesh pasqyrohet një pjesë e të ardhurave të deklaruar të mia (të deklaruar dhe nga subjekti Iacchelli), në vlerën 8.956.53 euro ... Gjithashtu, nga ana e Komisionit duhen njohur dhe të ardhurat e realizuara nga puna në të zezë (e bashkëshortit tim dhe e imja), që pavarësisht se të padeklaruara, janë frut i një pune të ligjshme dhe të ndershme, që nuk rrjedhin nga veprime abuzive apo kriminale dhe, si të tilla, justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive tona [...].*

14.7 Komisioni, në përfundim, ka arsyetuar se: [...] *pas përfshirjes në analizë të të ardhurave të fituara në emigracion nga subjekti dhe bashkëshorti i saj sipas vërtetimeve të përcjella me prapësimet, të cilat janë trajtuar gjerësisht në vendim, analiza financiare para marrjes së detyrës rezulton me vlerë negative -15,444,142 lekë, ndërsa nuk ndryshon për periudhën në*

<sup>7</sup> Referohuni akteve të përcjella nga ASHK-ja, me shkresën nr. \*\*\*/\* prot., datë \*\*.4.2024.



*detyrë të subjektit të rivlerësimit ... Në përfundim, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, Komisioni arrin në përfundimin se, nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, nuk rezultuan problematika, të cilat kanë të bëjnë me deklarim të pamjaftueshëm apo mungesë burimesh të ligjshme të krijimit të tyre, të cilat të jenë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Rezultoi e provuar se pasuritë janë krijuar kohë përpara se subjekti të ushtronte detyrën e ndihmëses ligjore dhe me të ardhurat e bashkëshortit të saj<sup>8</sup> [...].*

14.8 Komisioneri Publik, nga analizimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmëritë e konstatuara nga Komisioni për periudhën para dhe pas fillimit të detyrës, pamjaftueshmëri që lidhet me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në D-Vetting.

14.9 Sikurse është cituar dhe më sipër në këtë ankim, bazuar në parashikimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

14.10 Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshorti) nuk kanë arritur të provojnë të kundërtën lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të pasurive në pronësi të tyre. Referuar analizës së Komisionit, pamjaftueshmëria e konstatuar për periudhën para dhe pas fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, që në total rezulton në vlerën rreth - 16,000,000 lekë, tejkalon dhe nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

14.11 Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme pasuritë e deklaruara në D-Vetting, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**15.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

**16.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**17.** Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

---

<sup>8</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit, f. 20 e vendimit.

**18.** Bazuar në nenin Ç, D dhe F të aneksit të Kushtetutës, Kreun IV dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;

**19.** Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 789, datë 25.7.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj.*

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**